



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
TIRANË

Nr. 23 I REGJ.THEMELTAR
Nr. 34 I VENDIMIT

V E N D I M

“ N Ë E M Ë R T Ë R E P U B L I K Ë S ”

Gjykata e Apelit Tirane, e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : METUSH SARAÇI
ANËTAR : ZAMIR PODA
ANËTAR : EDMOND ISLAMAJ

Asistuar prej sekretares gjyqësore *Dh.Hasa*, sot më dt.31.03.2009, mori në shqyrtim, në shkallë të pare, në seancën publike, çështjen administrative me palë :

KËRKUES: Drejtoria e Pergjitheshme e Rrugeve, me adrese Rr.“Sami Frasheri”, Nr.33, Tirane, perfaqesuar nga juristi *Rezart Ruçi*.

PERSONA TE INTERESUAR:

1. Shoqëria “BE-HA-SE” shpk., me adrese: Ayten Sokak No.8, Tandogan, Ankara, Turqi.
(*ne mungese*)
- 2.Ministria e Puneve Publike,
Transportit dhe Telekomunikacionit
(*ne mungese*)

ME OBJEKT:

Njohje e vendimit Perfundimtar te Arbitrazhit Nderkombetar te dhene me date 2 Prill 2008 nga Dhoma Nderkombetare e Tregtise (ICC), Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit ne lidhje me çeshtjen No. 12016/ACS/FM "BE-HA-SE" kunder Drejtorise se Pergjitheshme te Rrugeve, Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Shqiperi.

BAZA LIGJORE:

- *Nenet 393-399 te K.Pr.Civile te Republikes se Shqiperise.*
- *Konventa Evropiane mbi Arbitrazhin Tregtar Nderkombetar, e ratifikuar nga Republika e Shqiperise me ligjin nr.8687, date 09.11.20000.*
- *Konventa per Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve te Huaja te Arbitrazhit, e ratifikuar nga Republika e Shqiperise me ligjin nr.8688, date 09.11.20000.*

GJYKATA E APELIT TIRANË

pasi dëgjoi relatimin e kryesuesit *Metush Saraçi*, perfaqesuesin e pales kerkuese juristin Rezart Ruçi, i cili kerkoi sipas objektit te kerkeses, ne mungese te paleve te interesuara, (dijeni sipas ligjit me shpallje), dhe pasi shqyrtoi çeshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Ne shqyrtimin gjyqsor te çeshtjes, rezultoi e provuar se me vendimin e Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit me Nr.12016/ACS/FM date 02.04.2008, me pale paditese "BE-HA-SE", INSAAT TICARET SANAYI LIMITED SIRKETI (Turqi), kunder Drejtorise se Pergjitheshme te Rrugeve, Ministria e Transportit – Shqiperi eshte vendosur:

1. Pala e paditur do t'i paguaje Pales Paditese shumen prej 1,725,878.07 Euro (nje milion e shtateqind e njetzet e pese mije e teteqind e shtatedhjete e tete Euro dhe shtate cent) plus interesa. Interesi do te filloje qe nga shuma 172,255.40 Euro nga 8 Marsi 2002 dhe shuma prej 1,553,622.67 Euro nga 6 Shtatori 2004, secila deri ne daten e pageses se plote, perlogaritur me interesa te perbere me baze vjetore ne fund te secilit vit, me perqindjen e interesit mbizoterues per nje vit per depozitat ne Euro te dhene nga Banka Kombetare e Shqiperise, ose ne mungese te saj me nje perqindje te tille te disponueshme per depozitat ne Euro te Bankes Kombetare Tregtare ne Shqiperi (Banka Kombetare Tregtare, Tirana.)
Keto shuma perfaqesojne shumen e akorduar per Pretendimin per Perfundimin e Punesimit.
2. Kostot e procedimit ne arbitrazh, te percaktuara nga Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit ne shumen prej 450,000.00 USD do te perballohen nga Pala Paditese.
3. Pala Paditese do t'i paguaje Pales se Paditur nje shume prej 1,664,008.52 Euro (nje milion e gjashteqind e gjashtedhjet e kater mije e tete Euro dhe psesedhjete e dy cent) si demshperblim per kostot e arsyeshme gjyqsore dhe te tjera dhe per shpenzimet dhe tarifat e Ekspertit.
4. Te gjitha pretendimet e tjera dhe / ose me te larta rrezohen.

Ky vendim i'u eshte komunikuar paleve nga Sekretariati i Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit (ICC), ne daten 8 Prill 2008, ne zbatim te nenit 28 te Rregullave te Arbitrazhit.

Kerkesa e paraqitur per njohjen e vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit eshte bazuar ne nenet: 393-399 te *K.Pr.Civile te Republikes se Shqiperise*; "*Konventa Evropiane mbi Arbitrazhin Tregtar Nderkombetar*", e ratifikuar nga Republika e Shqipersie me Ligjin nr.8687, date 09.11.2000; "*Konventa per Njohjen dhe ekzekutimin e Vendimeve te Huaja te arbitrazhit*", e ratifikuar nga Republika e Shqipersie me Ligjin nr.8688, date 09.11.2000.

Shqyrtimi gjyqsor i ceshtjes vertetoi se kerkesa e pales kerkuese Drejtoria e Pergjitheshme e Rrugeve, ka baze ligjore e per rrjedhoje duhet te pranohet.

Ne kete konkluzion arrihet, se ne baze te legjislacionit te shtetit Shqiptar, Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit prane Dhomes Nderkombetare Tregtare (ICC), nuk ka patur pengese ligjore ne shqyrtimin e kesaj ceshtje dhe vendimi i dhene prej saj ka qene ne kompetence te asaj gjykate Arbitrazhi.

Ne kontraten e nenshkruar me date 11 Gusht 1998, ne piken 67 te Kushteve te Kontrates, Pjesa I, Kushtet e Pergjithshme dhe Pjesa II – Kushtet e Zbatimit te Veçante, parashikohej se ne rast mosmarreveshje mes Punedhesisit dhe Sipermarresit, mosmarreveshja do t'i refereohet Arbitrazhit sipas rregullave te pajtimit dhe Arbitrazhi do te ishte Republika e Shqiperise dhe do te zhvilloheshin nga arbitra te emeruar sipas ketyre rregullave, ne gjuhen angleze.

Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit, ka zhvilluar nje proces te rregullt ligjor dhe Paleve ne proces u eshte dhene mundesia per te parashtruar te gjitha pretendimet e tyre.

Kerkesa e paraqitur nga pala Kerkuese para Gjykates se Apelit Tirane, per njohjen e Vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, me numer Nr.12016/ACS/FM date 02.04.2008 eshte ne perputhje me te gjitha percaktimet ligjore te shprehura ne Kreun IX “Njohja e vendimeve te shteteve te Huaja”.

Ne njohjen e ketij vendimi, nuk ekziston asnje pengese ligjore per t'i dhene fuqi zbatimit te tij ne Republiken e Shqiperise. Ne nenin 393 te K.Pr.Civile te RSH –se percaktohet se:

“Vendimet e gjykatave te shteteve te huaja njihen dhe zbatohen ne Republiken e Shqiperise, ne kushtet e parashikuara ne kete Kod ose ne ligje te veçanta.

Kur per kete qellim ka marreveshje te posaçme ndermjet Republikes se Shqipersie dhe shtetit te huaj zbatohen dispozitat e marreveshjes.”.

Ne Republiken e Shqiperise eshte ne fuqi ligji nr.8688, date 09.11.2000 “Per aderimin e R.SH.–se ne Konventen per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve te huaja te Arbitrazhit”.

Neni 122/2 i Kushtetutes percakton se Marreveshjet Nderkombetare prevalojne mbi legjislacionin e brendshem.

Si rezultat duhet te zbatohet Konventa e New York, ne lidhje me njohjen e vendimit te Arbitrazhit Nderkombetar si dhe dispozitat e K.Pr.C., ne qofte se nuk bien ne kundershtrim me te.

Vendimi i Arbitrazhit i marre me daten 2 Prill 2008 nga Dhoma Nderkombetare e Tregtise (ICC), Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit, ne lidhje me ceshtjen Nr.12016/ACS/FM ndermjet “BE-HA-SE”, Turqi (si Padites) dhe Drejtorise se Pergjitheshme te Rrugeve, Ministria e Puneve

Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (si e Paditur) është perfunduar dhe i formës së prere.

Ne nenin 394 të K.Pr.Civile janë percaktuar pengesat ligjore, për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja.

Ne çështjen në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit, konstaton se, nuk ekziston asnjë pengesë ligjore e percaktuar në dispozitën procedurale të sipercituar, që të mos lejojë dhenien fuqi të vendimit Nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008 i Gjykatës Nderkombetare të Arbitrazhit. Gjykimi i zhvilluar nga kjo Gjykatë (Arbitrazhit) është në pajtim të plote me parimet baze të legjislacionit shqiptar, si dhe nenit 5 të Konventës së New York "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të Arbitrazhit Nderkombetar".

Referenca ligjore për njohjen e vendimit të Arbitrazhit, është neni 399 i K.Pr.Civile në të cilin shprehet "*Dispozitat e këtij Kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit perfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj*".

Edhe në pikpamje të të provuarit, kerkimet e palës kerkuese shoqërohen me të gjitha provat e administruara në Gjykatën Nderkombetare të Arbitrazhit.

Kështu, midis akteve ndodhet vendimi i Gjykatës Nderkombetare të Arbitrazhit, në gjuhën Angleze e perkthyer në shqip dhe e legalizuar nga noteri si dhe njoftimi i bërë datë 07.04.2008 nga Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit drejtuar shoqërisë "BE-HA-SE" INSAAT TICARET SANAYI LIMITED SIRKETI (Turqi), lidhur me vendimin perfundimtar të çështjes me Nr.12016/ACS/FM në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në keto kushte, çmohet se, kërkesa e paraqitur nga pala Kerkuese është e bazuar në ligj, e si e tillë ajo, duhet të pranohet.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar në nenet 393 – 399 të K.Pr.Civile,

VENDOSI


Njohjen e Vendimit No.12016/ACS/FM, datë 02.04.2008 të Gjykatës Nderkombetare të Arbitrazhit, për çështjen me palë paditese "BE-HA-SE", INSAAT TICARET SANAYI LIMITED SIRKETI (Turqi), kundër Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve, Ministria e Transportit – Shqipëri.

Tiranë, më 31.03.2009

ANËTAR
E. ISLAMAJ



ANËTAR
Z. FODA



KRYESUES
M. SARAÇI

